REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1090/20
Datë/Datum. 14.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *(Komuna e Vushtrrise)*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *(64-20-022-1-1-1)*

Sa i përket tenderit për *(Frunizim me dru per ngrohje)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.P AGONITI

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Sheshi i Arberit Prishtine

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

(Kodi postar) *10000*

044/295/181

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Misim Beqiri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

agonitintp@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.12.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

N.T.P. "AGONITI" PRISHTINE

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi per kontrate eshte bere me daten 21.05.2020 ne platformen elektronike E-proukorimi *Njoftimi per dhenie te kontrates eshte bere me daten 26.11.2020.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e njoftimit te kontrates ka bere shkelje te nenit 7,59,72 te LPP-se

** *Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK me rastin e njoftimit per dhenie te kontrates 26.11.2020 ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-se sepse ka rekomundar me shperblim te kontrates OE "AOME" shpk i cili ka qene i pa pergjegjshem ngase i njejti nuk e ka plotesuar kriterin e referncave te njejta per furnizim me dru ,fakt i cili i cili eshte konfirmuar edhe me vendimin e OSHP-se PSH. Nr.596/20 i dt 18.09.2020. Me kete rast AK ka bere favorizim ndaj kompanis te rekomundar me shperblim me kontrate edhe pse i njejti eshte i pa pergjegjshem.
AK me rastin e njoftimit per dhenie te kontrates ka bere shkelje nenit 59 te LPP-se sepse ka rekomunduar nje OE te papergjegjshem me qense i njejti eshte shpallur i pa pergjegjshem edhe me vendim te OSHP-se me numer 596/20 dt 18.09.2020.Andaj sqarimi i AK se i njejti i pergjegjshem eshte i pergjegjshem edhe per kunder faktit se OE i rekomuduar ka ofruar dy lloje te referncave edhe te "njejta"edhe te "ngjashme"eshte i papranushem dhe ne te njejten kohe qesharak.
AK me rastin e njoftimit per dhenie te kontrates ka bere shkelje te nenit 72 te LPP-se ,sepse AK nga ne nuk ka kerkuar fare sqarime shtese konfrom nenit 72 te LPP-se.Eshte e vertete se heren e pare AK nga ne ka kerkuar sqarime shtese por puntori pergjegjese pran nderrmarjes time ne ate periudhe i ka pasur prinderit me COVID-19 dhe i njejti ka qene i

obliguar te rri ne izolim dhe per kete arsye as ne nuk kemi qene te njoftuar per kete gje nga ana e puntorit tone. Kete fakt ne ia kemi prezentuar edhe AK ne kerkesen tone per rishqyrtim por AK nuk e ka marr per baze fare.Ne potencojme se me dispozitat e reja te LPP-se,kur nje aktivetit i prokuorimit kthehet ne rivlersim kjo nenkupton qe aktviteti fillon nga pika zero dhe se AK konform nenit 72 te LPP-se ka qene i obliguar me rastin e rivleresimit te kerkoj nga ne sqarime shtese,gje te cilen nuk e ka bere. Andaj nga te cekuart me larte kerkojme nga paneli i OSHP-se qe ankesen tone ta aprovoj si te bazuar dhe kete aktivitet te prokuorimit ta kthj ne rivlersim dhe njekohsishte ta obligoj AK qe me rastin e rivlersimit te kerkoj sqarime shtese nga kompania jone.Gjithashtu kerkojm nga paneli shqyrtus i OSHP-se qe me rastin e mbajtes se seances degjimore te na ftojne edhe ne me qellim te prezentimi e provav tona dhe pretendimeve tona ankimore.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne si kompani na jane shkaktuar deme materiale ne vlere prej 150 euro ne rastin e pergaditjes se dosjes te tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*